

Emanuel Egbo: Me qan zemra qe nuk morrem tre piket

nga AlbaniaSoccer
E diel, 03 Nentor 2013 18:59



Trajneri i Bylisit, Emanuel Egbo e vleresoi ndeshjen e luajtuar nga skuadra e tij dhe si kundërshtarin, por gjithashtu u ndie shumë i zhgënjyer që skuadra e tij nuk arriti të merrte tre piket në takimin ndaj Vllaznisë. “Është kënaqësi të luash në Shkoder sepse është një publik dhe një ekip ekzemplar. Sa për ndeshjen, mund të them se duhej evituar ai gol që pesuam...Përqendrimi duhet mbajtur deri në fund. Neve na ndodh që sapo shenojmë na kap euforia.vetëm me anë të punës mund të përmirësohemi në difektet tona. Sot me qan zemra që nuk morem 3 piket pas atij golit spektakolar të Kulit. Në stërvitje do të mundohemi të përmirësojmë finalizimin. Stafit teknik ben punën e vet por luftari duhet të japë në fushë atë që kanë brenda, Për në çdo ndeshje është njëlojë nuk ka diferencë midis kundërshtarëve tane. Nëse në dalim në lojë tonë, nuk ka ekip të patyeshëm. Me këtë bindje do të përgatitemi për ndeshjen kundër Skenderbeut”, u shpreh Egbo pas barazimit që Bylis arriti në Shkoder ndaj Vllaznisë.